

KOMENTE DHE REKOMANDIME
MBI RAPORTIN E MONITORIMIT PËR VITIN 2021
PËR KOMISIONERËT PUBLIKË

I. Vlerësim i përgjithshëm

Institucioni i Komisionerëve Publikë, gjatë vitit 2021 ka administruar dhe menaxhuar fondet publike sipas programit “Veprimtaria e komisionerit publik” në grupin buxhetor 63 “Institucionet e sistemit të drejtësisë”.

I. Karakteristika kryesore të performancës së shpenzimeve

Në fund të vitit 2021, situata në lidhje me realizimin e shpenzimeve të buxhetit, krahasuar me faktin, sipas raportit të monitorimit të paraqitur nga ana e institucionit dhe sipas të dhënave të Sistemit Financiar Informatik të Qeverisë, paraqitet si më poshtë, *në mijë lekë*:

NR.	Emërtimi	Plani	Fakti	Përqindja e realizimit
1	<i>Shpenzime personeli</i>	65,800	65,744	99.9%
2	<i>Shpenzime të tjera korente</i>	4,550	3,032	66.6%
3	<i>Shpenzime kapitale</i>	0	0	-
TOTALI		70,350	68,776	97.8%

Siç shikohet nga tabela e mësipërme, shpenzimet për KP janë realizuar në rreth 100 përqind të planit për vitin 2021 për shpenzimet e personelit dhe 67 përqind shpenzimet e tjera korente. Në total KP ka një realizim faktik të planit për vitin 2021 në masën 98 përqind.

II. Informacion mbi volumin dhe madhësinë e ndryshimit të buxhetit.

Për Buxhetin e Komisionerëve Publikë për vitin 2021, situata në lidhje me ndryshimet në planifikim, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Programet	Buxheti fillestar 2021 (1)	Buxheti me ndryshime (2)	Diferenca (3=2-1)
Veprimtaria e komisionerit publik	74,200	70,350	-3,850

Për këtë institucion, situata në lidhje me ndryshimet e buxhetit gjatë vitit 2021, duke u nisur nga buxheti fillestar sipas ligjit nr. Nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, ka ardhur si pasojë fondeve akorduara si fonde shtesë nga Fondi i veçantë si dhe në zbatim të AN 34/2021 “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar”

Gjithashtu ka patur rishperndarje mes zërave të shpenzimeve korente pasi fondet buxhetore të miratuara në fillim të vitit 2021, nuk plotësojnë kërkesat e institucionit për shpenzime personeli, në përputhje me dispozitat ligjore në fushën e pagave.

III. Krahasimi i të dhënave faktike, të raportit të Institucionit me të dhënat e thesarit, për të njëjtën periudhë raportuese, në mijë lekë

Programi	Shpenzime korente			Shpenzime Kapitale		
	Institucioni	SIFQ	Diferenca	Institucioni	SIFQ	Diferenca
Veprimtaria e komisionerit publik	68,776	68,776	0	0	0	0
Totali			0	0	0	0

Siç shikohet nga tabela, nuk ka mospërputhje të të dhënave faktike të raportuara nga institucioni me të dhënat faktike të siguruara nga e Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë si për shpenzimet korente edhe për ato kapitale.

Programi “Veprimtaria e komisionerit publik” e KP ka përcaktuar qëllimin:

“Procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë ka për qëllim garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi”.

Për arritjen e këtij qëllimi është përcaktuar objektivi:

“Mbrotjtja e interesit publik gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit, respektimi i parimit të paanësisë dhe pavarësisë, procesit të rregullt ligjor, transparencës dhe frymës së bashkëpunimit ndërmjet dy komisionerëve publikë, ONM dhe institucioneve të tjera”

Sipas relacionit dhe tabelave të paraqitura nga Komisionerët Publikë, produkti i këtij institucioni “Çështje të njoftuara nga KPK dhe shqyrtuar nga KP brenda afateve ligjore” nga 140 të planifikuara për vitin 2021, gjatë vitit 2021 janë realizuar në sasi 171 çështje.

IV. Komente dhe rekomandime

- Theksojmë se paraqitja e informacionit si dhe të dhënat e raportuara në raportin e monitorimit duhet të jetë në përputhje me përcaktimet e bëra në Udhëzimin nr. 22, datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e Qeverisjes Qendrore”, specifikisht sipas formateve të përcaktuara në paragrafin 49, të këtij udhëzimi. Vërejmë që të dhënat e raportuara në raportin e monitorimit të KP, janë sipas formateve të përcaktuara në këtë udhëzim në anekset përkatëse, konkretisht Aneksi nr 1, Aneksi nr 2, Aneksi nr 3, Aneksi nr 4 dhe Aneksi nr 5.
- Për shpenzimet buxhetore paraqitja e tyre duhet të bëhet sipas anekseve nr. 1 “Raporti i shpenzimeve sipas Programeve” dhe aneksi 2 “Raporti i shpenzimeve të Programit sipas

Artikujve buxhetorë”. Këto të dhëna duhet të shoqërohen me një analizë të lidhur me të gjithë faktorët që kanë ndikuar në nivelin e realizimit të tyre. Sa i përket kësaj pjese raporti i paraqitur nga KP është i saktë.

- Për të siguruar paraqitjen sa më mirë të lidhjes midis realizimit të objektivave të politikës së programit me realizimin e treguesve të performancës/produkteve, të dhënat mbi realizimin e tyre duhet të paraqiten sipas aneksit nr. 4 “Raporti i realizimit të objektivave të politikës së programit”, të përcaktuar në udhëzimin e mësipërm. I rëndësishëm është edhe plotësimi i komenteve për secilin tregues për të evidentuar si arritjet edhe problematikat. Raporti i monitorimit të KP ka të plotësuara tabelat dhe gjithashtu në relacionin e tij ka një analizë sasiore të produkteve.
- Të dhënat faktike të raportuara nga institucioni duhet të jenë të rakorduara me të dhënat faktike të Sistemit Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ). Për këtë pikë vërejmë që të dhënat e raportuara në raportin e monitorimit nga KP janë të njëjta me të dhënat faktike të siguruar nga SIFQ, si për shpenzimet korente edhe për shpenzimet kapitale.

Mbështetur në sa më sipër duke parë edhe paraqitjen e raportit të KP vlerësojmë jo vetëm paraqitjen në kohë të tij por edhe paraqitjen sipas standardeve të udhëzimit të monitorimit.

V. Publikimi:

Raporti i Monitorimit për vitin 2021, është publikuar në faqen zyrtare të Komisionerëve Publik.

Linku: <http://ikp.al/buxheti/>